



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-CA-2022-01

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Kai Ambos  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 28 korrik 2022

**Gjuha e origjinalit:** Anglishte

**Klasifikimi:** **Publik**

---

**Vendim mbi Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për Mbajtjen në  
Paraburgim**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Xhek Smith

**Mbrojtjes së Hysni Gucatit:**  
Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtjes së Nasim Haradinajt:**  
Tobi Kadman

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit”, ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),<sup>1</sup> duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 172 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim “Njoftimin e Prokurorisë dhe Kërkesën për Mbajtjen në Paraburgim”, dorëzuar më 17 qershor 2022 (“Kërkesa”).<sup>2</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 shtator 2020, z Hysni Gucati (“Gucati”) dhe z Nasim Haradinaj (“Haradinaj”) (bashkërisht, “të akuzuarit”) u arrestuan në Kosovë në bazë të fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Vetëm.<sup>3</sup> Ata u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, përkatësisht më 25 dhe 26 shtator 2020.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> F00011, Vendim për Caktimin e Panelit të Dhomës së Apelit, 21 qershor 2022.

<sup>2</sup> F00010, Njoftim i Prokurorisë dhe Kërkesë për Mbajtje në Paraburgim, 17 qershor 2022 (shpërndarë më 20 qershor 2022) (“Kërkesa”).

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-07, F00015, Njoftim i Arrestimit Sipas Rregullës 55(4), 25 shtator 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar publik më 15 tetor 2020); KSC-BC-2020-07, F00012/A01/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Hysni Gucatin, 25 shtator 2020; KSC-BC-2020-07, F00016, Njoftim i Arrestimit Sipas Rregullës 55(4), 25 shtator 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar publik më 15 tetor 2020); KSC-BC-2020-07, F00012/A03/COR/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Variantit të Korrigjuar të Fletarrestimit për Nasim Haradinajn, 26 shtator 2020. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-07, F00012, Vendim mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi, 24 shtator 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar publik më 9 tetor 2020).

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-07, F00018, Njoftim i Pranimi të Hysni Gucati në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 25 shtator 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar publik më 15 tetor 2020); KSC-BC-2020-07, F00020, Njoftim i Pranimi të Nasim Haradinajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 26 shtator 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar publik më 15 tetor 2020). Shih gjithashtu KSC-BC-2020-07, F00012/A02/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Urdhrit për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 25 shtator 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* dorëzuar më 24 shtator 2020, riklasifikuar konfidencial dhe *ex parte* më 9 tetor 2020); KSC-BC-2020-07, F00012/A04/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Urdhrit për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 26 shtator 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* dorëzuar më 24 shtator 2020, riklasifikuar konfidencial dhe *ex parte* më 9 tetor 2020).

2. Më 18 maj 2022, Trupi Gjykses i Çështjes Nr. KSC-BC-2020-07 ("Trupi Gjykses") nxori vendimin me anë të të cilit i shpalli të dy të akuzuarit fajtorë për pesë nga gjashtë akuzat me të cilat ishin ngarkuar dhe dënoi secilin me katër vjet e gjysëm burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe me një gjobë prej njëqind eurosh ("Aktgjykimi").<sup>5</sup>

3. Më 17 qershor 2022, të akuzuarit dorëzuan njoftimin për apel.<sup>6</sup> Po atë ditë, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi Kërkesën e saj, me anë të së cilës e njoftoi Kryetaren se nuk synonte të apelonte kundër Aktgjykimit dhe kërkonte që, në rast se të akuzuarit kërkonin të apelonin kundër Aktgjykimit, Paneli duhet t'i mbante në paraburgim.<sup>7</sup>

4. Më 22 qershor 2022, Kryegjykatësja e Panelit i ftoi të akuzuarit të jepnin përgjigjet e tyre ndaj Kërkesës, në rast do të kishte të tilla, brenda dhjetë ditësh nga shpërndarja e saj dhe ZPS-në të jepte kundërpërgjigje, në rast do të kishte të tillë, brenda pesë ditësh nga marrja e përgjigjeve.<sup>8</sup>

5. Më 30 qershor 2022, Gucati dorëzoi përgjigjen e tij ndaj Kërkesës.<sup>9</sup> Haradinaj nuk u përgjigj.<sup>10</sup> ZPS-ja nuk u kundërpërgjigj.

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit, 18 maj 2022 (versioni konfidencial dorëzuar më 18 maj 2022) ("Aktgjykimi"), para. 1012-1017.

<sup>6</sup> Shih F00008, Njoftim i Mbrojtjes së Haradinajt për Apelimin e Aktgjykimit, 17 qershor 2022 (shpërndarë më 20 qershor 2022); F00009/RED, Version i Redaktuar Publik i Njoftimit për Apel të Gucatit në lidhje me Aktgjykimin KSC-BC-2020-07/F00611 ("Aktgjykimi") sipas Nenit 46(1)(a), (b) dhe (c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe Rregullës 176(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), 17 qershor 2022 (shpërndarë më 20 qershor 2022; versioni konfidencial u dorëzua më 17 qershor 2022).

<sup>7</sup> Kërkesa, para. 1, 4. Shih gjithashtu Kërkesa, para. 2.

<sup>8</sup> F00012, Urdhër për Caktimin e Datës për një Konferencë Para Apelit dhe Çështje Lidhur me Të, 22 qershor 2022 ("Urdhër për Caktimin e Datës"), para. 8, 11.

<sup>9</sup> F00024, Përgjigje ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Mbajtjen në Paraburgim, 30 qershor 2022 ("Përgjigja e Gucatit"). Për shkak të një gabimi të administratës, dosja e protokolluar është shpërndarë më 5 korrik 2022. Shih Transkripti, Konferenca Para Apelit, 5 korrik 2022, f. 8 rreshti 24 - f. 10 rreshti 22.

<sup>10</sup> Krahaso me F00015, Njoftim i Mbrojtjes së Haradinajt lidhur me Pikat e Rendit të Ditës para Konferencës Para Apelit të 5 korrikut 2022, 27 qershor 2022, para. 10.

## II. DISKUTIM

### A. PARASHTRIMET E PALËVE

6. ZPS-ja parashtron se konstatimet e Trupit Gjykues shkojnë më tej se standardi i dyshimit të bazuar sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit, dhe se rreziqet sipas nenit 41(6)(b) për të cilat ka arritur konstatimin Trupi Gjykues janë në nivelin më të lartë pas shpalljes fajtorë të të akuzuarve. Sipas ZPS-së, vazhdojnë të mos ekzistojnë kushte të cilat do të mund të ulnin mjaftueshëm këto rreziqe dhe nuk mund të shtrohet çështja e proporcionalitetit po të mbahet parasysh zhvillimi efikas i gjyqit, dënimi afatgjatë, dhe afatet e përpikta të procedurave të apelit.<sup>11</sup>

7. Gucati përgjigjet duke thënë se, duke qenë se aktualisht nuk i është bërë kërkesë Trupit Gjykues ose Panelit të Gjykatës së Apelit për të urdhëruar lirimin e të akuzuarit, ai nuk ka përgjigje thelbësore ndaj Kërkesës, e cila, nga ana e saj, as nuk kërkon, as nuk bën të nevojshëm lëshimin e ndonjë urdhri ose mjeti juridik.<sup>12</sup> Megjithatë, ai parashtron se rezervon të drejtën për të kërkuar nxjerrjen e një urdhri për lirim nga paraburgimi në çdo fazë të procedurës së apelit, bazuar në nenin 46(8) të Ligjit.<sup>13</sup>

### B. VLERËSIMI I PANELIT TË GJYKATËS SË APELIT

8. Sipas nenit 46(8) të Ligjit, përpos nëse trupi gjykues ose Paneli i Gjykatës së Apelit urdhëron që të veprohet ndryshe, personi i dënuar mbetet në ndalim në pritje të apelit.<sup>14</sup> Nga kjo dispozitë del se, kur një person shpallet fajtor, si rregull ai apo ajo mbahet në paraburgim dhe lirim i është përjashtim. Më tej, Paneli vëren se, sipas rregullës 174 të Rregullores, me përjashtim të rregullës 58, rregulla 56 deri tek rregulla 60 lidhur me paraburgimin zbatohen *mutatis mutandis* gjatë procesit para Panelit të

---

<sup>11</sup> Kërkesa, para. 3.

<sup>12</sup> Përgjigja e Gucatit, para, 5-6.

<sup>13</sup> Përgjigja e Gucatit, para. 7.

<sup>14</sup> Shih Urdhër për Caktimin e Datës, para. 8. Shih gjithashtu F00020/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Tretë të Gucatit për Lirim të Përkohshëm për Arsyje Humanitare, 4 korrik 2022 (versioni konfidencial dhe *ex parte* dorëzuar më 30 qershor 2022), para. 17.

Apelit. Interpretimi i këtyre rregullave bazohet në prezumimin e mbajtjes në paraburgim që, siç është shpjeguar më lart, buron nga neni 46(8)i Ligjit. Në lidhje me këtë, Paneli vëren në fund se Ligji – në këtë rast neni 46(8) – ka përparësi mbi Rregulloren kur ka mospërputhje.<sup>15</sup> Në këtë kontekst, Paneli është i mendimit se, ndryshe nga periudha para dënimit në shkallën e parë, kur, bazuar mbi nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjykues duhet automatikisht të shqyrtojë mbajtjen në paraburgim çdo dy muaj, një gjë e tillë nuk është kusht gjatë procedurës së apelit pas shpalljes së fajësisë.

9. Dallimi mes periudhës para dhe pas shpalljes së fajësisë për sa i përket mbajtjes në paraburgim është në përputhje me nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”),<sup>16</sup> që pasqyrohet me besnikëri në nenin 29 të Kushtetutës së Kosovës.<sup>17</sup> Sipas nenit 5(1)(a) të KEDNJ-së, askujt nuk mund t’i hiqet liria përjashtuar, ndër të tjera, rastin kur një person burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente. Këtu nënkuptohet dënimi nga një gjykatë e shkallës së parë, pasi në këtë pikë pushon së vepruari mbrojtja që sigurojnë nenet 5(1)(c) dhe (3) të KEDNJ-së.<sup>18</sup> Kjo mbrojtje përfshin rishqyrtimin e rregullt të mbajtjes në paraburgim dhe kërkon lirim të përkohshëm të të akuzuarit në momentin që mbajtja e tij apo e saj e mëtejshme në paraburgim pushon së qeni e arsyeshme pasi, para shpalljes së dënimit nga gjykata e shkallës së parë, prirja është në drejtim të liritimit.<sup>19</sup>

<sup>15</sup> Shih rregulla 4(2) e Rregullores. Shih gjithashtu neni 19(3) i Ligjit; KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbjtjen e tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020, para. 30.

<sup>16</sup> Shih ECtHR, *Wemhoff v. Germany*, no. 2122/64, Judgment, 27 June 1968 (“*Wemhoff v. Germany* Judgment”), pp. 19-20, para. 9.

<sup>17</sup> Shih gjithashtu nenin 53 të Kushtetutës së Kosovës (që parashikon se të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut).

<sup>18</sup> Shih psh. ECtHR, *Selahattin Demirtaş v. Turkey*, no. 14305/17, Judgment, 22 December 2020, para. 290; ECtHR, *Štvrtecký v. Slovakia*, no. 55844/12, Judgment, 5 June 2018, para. 55; *Wemhoff v. Germany* Judgment, pp. 19-20, para. 9.

<sup>19</sup> Shih ECtHR, *Bykov v. Russia*, no. 4378/02, Judgment, 10 March 2009, para. 61.

10. Interpretimi i mësipërm përputhet edhe me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.<sup>20</sup> Për më tepër, ai nuk është në dëm të të akuzuarit, duke qenë se ky i fundit gëzon të drejtën të kërkojë rishqyrtimin e mbajtjes në paraburgim në çdo kohë.<sup>21</sup>

11. Bazuar në sa më lart, Paneli pajtohet me pohimin e Gucatit se Kërkesa nuk kërkon lëshimin e ndonjë urdhri apo mjete juridik.<sup>22</sup>

### III. VENDIM

12. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

**DEKLARON** se Kërkesa është e tejkaluar; dhe

**KONFIRMON** se të akuzuarit do të vazhdojnë të mbahen në paraburgim në pritje të apeleve të tyre, përveç nëse Paneli nxjerr një urdhër të ndryshëm.

/nënshkrimi/

**Gjykatësja Mishelë Pikar,  
Kryegjykatëse**

E enjte, 28 korrik 2022

Hagë, Holandë

---

<sup>20</sup> *Krahaso* nenin 193 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 04/L-123, 13 dhjetor 2012 (“Kodi i Procedurës Penale të Kosovës”) (që garanton rishikimin automatik çdo dy muaj të mbajtjes në paraburgim deri në përfundimin e gjyqit kryesor) *me* nenin 389(5) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (që garanton një shqyrtim të vetëm nga gjykatësi raportues brenda pesë ditësh nga marrja e dokumentacionit të çështjes në rastin e apeleve kundër aktgjytimeve).

<sup>21</sup> Shih neni 41(2) i Ligjit.

<sup>22</sup> Shih Përgjigjja e Gucatit, para. 6.